



RAPORT

TË RINJTË KUNDËR KORRUPSIONIT NË ARSIMIN E LARTË

(referuar të dhënave të rezultuara nga një anketim i zhvilluar në katër universitete publike të vendit në Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Vlorë)

Maj, 2019

• **Punoi raportin:**

Majlinda Keta, eksperte e jashtme, KShH

Rovena Vuksani, juriste/asistente projekti, KShH

• **Rishikoi raportin:**

Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Angjelina Pulluqi, koordinatorë projekti, KShH

Erida Skëndaj, drejtore ekzekutive, KShH

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për autorin. Asnjë pjesë e këtij teksti nuk mund të riprodhohet pa lejen apo citimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Ky raport është pjesë e nismës “Të rinjtë luftojnë korrupsionin në arsimin e lartë”, që mbështetet financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë.



Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati “TeknoProjekt” Shk. 2, Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia postare nr.1752

Tel.: +355 4 2233671; Cel.: +355 682023699

<https://www.facebook.com/KomitetishqiptariHelsinkit>

E-mail: office@ahc.org.al;

www.ahc.org.al

Të dashur lexues,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) i krijuar më 16 Dhjetor 1990, ka si mision të punës së tij promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Një nga fushat që ka qenë në vëmendje të vazhdueshme të veprimtarisë së KShH-së është edhe lufta ndaj korrupsionit në nivele të ndryshme të administratës shtetërore dhe jo vetëm.

KShH ka vlerësuar dhe vlerëson pozitivisht nismat e marra dhe legjislacionin e miratuar që po zbatohet me qëllim për të garantuar pastërtinë, fuqizimin dhe pavarësinë e organeve të sistemit të drejtësisë. Por korrupsioni nuk është i veçuar. Ai është mjaft i përhapur. Raste jo të pakta korrupsioni janë vërtetuar në sektorë të ndryshëm të administratës publike. Faktet e këtyre kohëve të fundit tregojnë se edhe në sektorin e arsimit të lartë, madje edhe të arsimit në përgjithësi rastet e korrupsionit nuk kanë munguar.

Reforma në arsimin e lartë siç dihet ishte e domosdoshme, por KShH mendon se rezultatet e saj u shoqëruan me elemente të vetëkënaqësisë, të dobësimit të kontrollit dhe të llogaridhënies në drejtime nga më të ndryshmet apo edhe të dobësimit dhe anashkalimit të organeve të përfaqësimit të grupeve studentore. Për më tepër, reforma në arsim nuk adresoi dhe rrjedhimisht as nuk kontribuo për të luftuar korrupsionin në radhët e drejtuesve, personelit akademik dhe logjistik të sistemit të lartë universitar.

Demokratizimi i organizimit dhe funksionimit të sistemit të lartë kërkon gjithashtu aktivizimin më të madh të organizatave të shoqërisë civile, të cilat mund të veprojnë me një larmishmëri veprimtarish me natyrë ndërgjegjëse, monitoruese, advokuese dhe lobuese.

Nisur nga problematikat me të cilat përballet sistemi i arsimit të lartë në vendin tonë, KShH ndërmori nismën “Të rinjtë luftojnë korrupsionin në arsimin e lartë”, e cila u zbatua gjatë periudhës Tetor 2017 - Maj 2019. Kjo nismë synoi fuqizimin e studentëve për t’i rezistuar korrupsionit, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në promovimin dhe forcimin e integritetit të tyre, si elementi më i rëndësishëm i çdo qenieje njerëzore që nuk bëhet pjesë e akteve apo aferave korruptive.

Në këtë raport studimor, KShH ka analizuar nga pikëpamja cilësore dhe sasiore të dhënat e rezultuara nga aktivitetet e projektit. Një fokus të veçantë në këtë raport zë analiza e përgjigjeve të dhëna nga studentët në kuadër të një anketimi të realizuar në 4 Universitetet publike ku kjo nismë është zbatuar (Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë).

Nisma të tilla sikurse është ajo e realizuar nga KShH janë vetëm fillimi ose përbëjnë hapat e parë të një rrugëtimi të gjatë dhe sfidues. Në këtë rrugëtim, ka shumë aktorë që duhet të kontribuojnë, përfshi këtu edhe median që ka një rol të pazëvendësueshëm në ndërgjegjësimin e opinionit publik. Mgjith, kontribuesit kryesor në këtë proces janë vetë studentët, të cilët me maturi dhe në forma

demokratike mund të kontribuojnë në shumë aspekte të demokratizimit, transparencës dhe rritjes së përgjegjshmërisë së sistemit të lartë arsimor.

KShH dëshiron të falënderojë stafin e angazhuar në realizimin e këtij projekti si dhe ekspertët e jashtëm, Znj. Fjoralba Caka dhe Znj. Majlinda Keta, për kontributin e çmuar dhe profesional që kanë dhënë. Gjithashtu, falënderojmë dhe Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për bashkëpunimin shumë të mirë që kemi pasur ndër vite sa u përket të drejtave dhe lirive të njeriut në vendin tonë, si dhe për mbështetjen financiare që ka dhënë në realizimin e kësaj nisme.

Ju urojmë lexim të mbarë të këtij Raporti!

Me konsideratë,

Erida Skëndaj,
Drejtoresh Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

1. PARATHËNIE

Prej muajit Tetor 2017, KShH ndërmori nismën “Të rinjtë luftojnë korrupsionin në arsimin e lartë” me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Ambasadën e SH.B.A.-së, në Tiranë. Kjo nismë synoi adresimin e problemeve të korrupsionit në sistemin e lartë arsimor në Shqipëri, promovimin e integritetit dhe fuqizimin e të rinjve, të cilët janë burim i rëndësishëm për të gjeneruar zgjidhje efektive në luftën kundër korrupsionit në Fakultetet/Universitetet e tyre.

Të gjitha aktivitetet e realizuara në kuadër të kësaj nisme kishin si aktorë dhe përfitues kryesorë studentët. Pavarësisht se nuk ka qënë e lehtë të flasësh dhe të adresosh një problem të tillë në takimet e realizuara me studentët, sërisht mes tyre ka patur shumë të rinj dhe të reja me guxim, të cilët në mënyrë proaktive kanë adresuar dhe trajtuar një sërë problematikash me të cilat përballet sot sistemi i lartë arsimor në optikën e tyre. E nisur si një nismë, e cila do të garantonte gjenerimin e ideve dhe iniciativave nga poshtë-lart, nga studentët drejt strukturave përgjegjëse për garantimin e një sistemi arsimor larg fenomeneve korruptive, janë organizuar një sërë aktivitetesh në një shtrirje relativisht të gjerë gjeografike, konkretisht në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, “Luigj Gurakuqi” Shkodër, “Aleksandër Xhuvani” Elbasan dhe “Ismail Qemali” Vlorë.

KShH, duke vlerësuar si thelbësor rolin e rektoratit dhe dekanatit të universiteteve publike ku do të realizoheshin veprimtaritë e planifikuara, ju drejtua me shkresë zyrtare secilit prej titullarëve të këtyre universiteteve duke kërkuar bashkëpunimin e tyre. Jo të gjithë kanë treguar dëshirën dhe vullnetin për të kontribuar në krijimin e lehtësive të nevojshme që mundësonin mbarëvajtjen e kësaj nisme.

Në bashkëpunim me figura të njohura të jetës akademike, mediatike dhe më gjerë, KShH organizoi fillimisht 4 forume në ambientet e Universiteteve të sipërpërmendura, kryesisht me studentë të fakulteteve të shkencave shoqërore dhe drejtësisë. Këto forume synuan nxitjen e debatit mes studentëve rreth problematikave të natyrës korruptive në arsimin e lartë. Pavarësisht pjesëmarrjes së gjerë nga studentët, mesatarisht u evidentua hezitimi i tyre në referimin e problemeve apo zgjidhjeve potenciale për reduktimin e tyre. Në vlerësimin tonë, hezitimi erdhi edhe për shkak të frikës apo intimidimit të studentëve për të folur hapur për shkak se aktivitetet u realizuan në ambientet e universiteteve. Në vijim, KShH realizoi forumet e dyta “Anti-corruption coffee hours” me studentë të universiteteve në ambiente jashtë universiteteve, të cilat përceptohen si më miqësore dhe të rehatshme për studentët për të shprehur në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar mendimet e tyre. Kështu, gjatë “orevë të kafesë kundër korrupsionit”, u evidentua se studentët ndiheshin më të lirshëm për të diskutuar, duke adresuar raste të përgjithshme dhe konkrete të akteve korruptive dhe veprimeve të padrejta me të cilat ishin ndeshur gjatë jetës studentore.

Nisma “Të rinjtë kundër korrupsionit në arsimin e lartë” ka patur si qëllim edhe nxitjen e shëmbujve të mirë të integritetit dhe profesionalizmit në rradhët e stafit akademik, të cilët ndonjëherë nuk vlerësohen sa duhen nga komuniteti. Si rezultat i zbatimit të aktivitetit “Naming and Faming”, i cili u realizua gjatë ditës së mësuesve, më datë 7 mars, studentët patën mundësi që të votonin unanimisht për pedagogun/pedagogen që ata e vlerësonin si frymëzues në punën fisknike të mësimdhënies. Pas votimit nga studentët, për pedagogët fitues, konkretisht 3 pedagogë nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, 3 pedagogë nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe 1 pedagog nga

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, u vlerësuan simbolikisht në emër të KShH-së, nëpërmjet dërgimit të një tufe me lule dhe një kartoline simbolike. Ndër 4 universitetet ku është fokusuar ky projekt, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, refuzoi kërkesën shkresore të KShH-së për realizimin e këtij aktiviteti në ambientet e universitetit, pa bërë të qartë arsyet e refuzimit.

Aktivizimi studentor ka qënë maksimal gjatë takimeve të ideuara në formatin “Akademia e Liderve të Rinj me Integritet”. Përveç adresimit konkret të çështjeve më shqetësuese gjatë jetës studentore, pjesëmarrësit në akademi prezantuan edhe zgjidhje konkrete për reduktimin e fenomeneve korruptive, nëpërmjet prezantimit të projekteve të ndryshme të orientuara drejt këtij fokusi.

Vlerësojmë se pas secilit aktivitet, por sidomos pas Akademisë “Lider të Rinj me integritet”, mbështetja dhe besimi nga studentët për nismën e KShH rritej në mënyrë progresive, dhe kërkesat drejt stafit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për angazhime të mëtejshme në nisma të ngjashme shtoheshin dita-ditës. Një rrjet i tillë i krijuar do t’i shërbejë më së miri qëndrueshmërisë së rezultateve të kësaj nisme, por edhe rritjes së angazhimit të të rinjve dhe motivimit për të realizuar nisma të tilla ku vetë ata të jenë protagonist dhe jo vetëm përfitues.

KShH angazhoi disa prej studentëve pjesë e rrjetit të të rinjve me integritet për realizimin e një anketimi me studentët. Ata kontribuan në shpërndarjen e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave nga komuniteti studentor, me qëllim vlerësimin e nivelit të integritetit të institucionit universitar mirëqeverisjen e këtyre institucioneve, sikurse edhe kontributeve për një aktivizëm dhe protagonizëm studentor.

Në rrafshin institucional integriteti përbëhet nga disa karakteristika si: llogaridhënia, transparenca, rezistenca dhe reagueshmëria ndaj korrupsionit, etika, pastërtia e figurës, profesionalizmi dhe ndershmëria. Për identifikimin e treguesve të tillë, ekspertët e KShH-së hartuan një pyetësor dedikuar vlerësimit të vetë studentëve, të cilët preken në mënyrë të drejtpërdrejtë nga niveli i cilësisë së universiteteve publike. Përmbajtja e pyetësorit u mbështet gjithashtu tek të drejtat dhe liritë studentore të parashikuara në Ligjin për Arsimin e Lartë të RSH, Statutin, Rregulloren e Brendshme, Kodin Etik apo paketa informuese në secilin nga 4 universitetet e përfshira në projekt.

Në vetvete, anketimi synoi të vlerësojë angazhimin studentor në jetën universitare, cilësinë e qeverisjes në nivele të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë, duke përfshirë këtu edhe organet e përfaqësimit studentor, lëvizjet studentore, angazhimet e studentëve në shoqërinë civile apo rrjeteve ndërkombëtare studentore etj. Pyetësi u organizua në 5 seksione pyetjesh për matjen e treguesve si: legjislacioni për arsimin e lartë, informimi dhe përdorimi i tij nga studenti, aplikimet dhe universiteti/fakulteti, procesi i transparencës në kurrikulën universitare, zgjedhjet dhe funksionimi i këshillave studentore dhe studenti rezistent ndaj korrupsionit, besueshmëria në institucionalizmin universitar. Pyetësorët janë publikuar në pjesën e fundit të këtij raporti studimor.

2. GJETJET KRYESORE TË ANKETIMIT ME STUDENTËT

Anketimi i një kampioni të gjerë studentësh rreth 1799 studentë në universitetet “Aleksandër Moisiu” Durrës, “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, “Ismail Qemali” Vlorë dhe “Luigj Gurakuqi” Shkodër, shumica e të cilëve janë në fazën e ndjekjes së studimeve Bachelor, evidentoi këto gjetje kryesore:

Numri i studentëve të anektuar që kanë njohuri për legjislacionin e arsimit të lartë paraqitet në nivele të ulëta. Konkretisht, një në pesë të anketuar kanë njohuri për ligjin për arsimin e lartë kundrejt 25% e të anketuarve që nuk kanë aspak njohuri për të. Krahasuar me pjesën tjetër të studentëve të anketuar, studentët anëtarë të Këshillave Studentorë e zotërojnë më mirë paketën ligjore universitare (Ligjin për arsimin e lartë, Kodin Etik dhe Rregulloret e Brendshme).

Studentët e anketuar janë shprehur në masën 45,2% se nuk kanë mundësi të kandidojnë lirisht si përfaqësues të Këshillit studentor sa herë bëhen zgjedhje në Fakultet. Anketimi paraqet një situatë shqetësuese lidhur me angazhimin e ulët të studentëve në struktura apo lëvizje studentore, ku respektivisht, vëtëm 3.61% e të anketuarve bejnë pjesë në lëvizje studentore dhe 2.33 % në struktura si Këshilli Studentor.

Pjesa më e madhe e studentëve, 58.8% e tyre referojnë se nuk kanë njohuri dhe dijeni për procesin e zgjedhjeve për këshillat studentore. Prej tyre referohet se ka ndërhyrje të personelit apo institucioneve akademike dhe partive politike në proceset zgjedhore. Ndikimi i partive politike në zgjedhjet në këto këshilla është më i lartë në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, i ndjekur nga universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Këto të dhëna, edhe pse të referuara në formën e perceptimeve, kemi mendimin se minojnë besueshmërinë, pavarësinë dhe meritokracinë e këtyre strukturave që duhet të zgjidhen me votë të lirë, të paanshme dhe të ndershme.

Sa i takon efikasitetit të funksionimit të Këshillave në mbrojtjen e interesave të studentëve, pothuajse 1 në 4 studentë shprehen pozitiv, përkundrejt 39.1% të tyre të cilët e kundërshtojnë duke pohuar se Këshillat Studentorë nuk realizojnë aktivitete në mbrojtje të interesave të studentëve.

Është pozitiv fakti që rreth 72.4% të studentëve të anketuar kanë qenë plotësisht, pjesërisht ose thjesht dakord, për sa i takon respektimit të të barazisë në procedurat e ndjekura nga universiteti/fakulteti. 1 në 5 studentë të anketuar (ose 20% e tyre) janë kritikë për procedurat e praktikave profesionale, këshillimeve të karrierës, aplikimit për bursat jashtë Shqipërisë dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore që ofrojnë fakultet e tyre.

Ka një përqindje të lartë të studentëve të anketuar (prej 43,1%) të cilët pohojnë se nuk përdorin literaturë të hapur¹ për përgatitjen e tyre në kurset akademike, ndërkohë që 1 në 3 studentë pranojnë se përdorin literaturë të detyruar nga pedagogu i lëndës në përgatitjen për kursin. Më pak se një në pesë studentë pranojnë se përdorin tekste me ISBN-të deklaruar.

¹ Termi “literaturë e hapur” është përdorur për rastet kur është studenti që vendos mbi tekstin referues në literaturën e programuar

20% e studenteve të anketuar shprehin se nuk njohin publikisht cilësinë e vlerësimit në pjesëmarrjen e tyre gjatë seminareve ku janë aktive, mbështetur kjo edhe nga 40% e studentëve, të cilët pohojnë se ky vlerësim nuk është gjithmonë transparent.

Rreth 20.6% e studentëve të anketuar pohojnë se nuk realizohet fare procesi i sekretimit në provimet e vlerësimit përfundimtar, mbështetur kjo edhe nga 47,7% e studentëve, të cilët pohojnë se ky proces nuk ndodh gjithmonë.

Një numër relativisht i ulët i studentëve kanë përfituar nga procesi i rishikimit të notës, mbështetur kjo edhe nga 32,6% të cilët kanë përfituar nga ky proces me raste.

Shqetësues paraqitet raportimi nga studentët e anketuar për favoret seksuale nga pedagogët e tyre. Konkretisht rreth 25% e studentëve (ose 1 në 4 studentë) të anketuar referuan se kanë qenë subjekt i kërkesave apo presioneve për favore seksuale nga pedagogët në këmbim të notës.

Pothuajse gjysma e studentëve (ose 1 në 2 studentë) referojnë problematikën e mos respektimit të afatit të deklaruar për të marrë përgjigje lidhur me dokumentacionin që ata kanë kërkuar. Krahësuar me miqtë e tyre, studentët e vlerësojnë vetën me rezistentë ndaj fenomeneve korruptive.

Institucionet kryesore tek të cilat studentët besojnë se mund të mbështeten për rezistencën dhe reagueshmërinë e tyre ndaj korrupsionit janë Dekani, Rektori dhe Media.

3. METODOLOGJIA E ANKETIMIT

Anketimi është zhvilluar mbi bazën e të dhënave parësore të mbledhura kundrejt një vrojtimi me anë të një pyetëso. Fokusi i këtij anketimi ishin Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, “Ismail Qemali” Vlorë dhe “Luigj Gurakuqi” Shkodër, kryesisht i fokusuar për sistemin e studimeve Bachelor.

Konkretisht anketimi është realizuar në:

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 1. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike 2. Fakulteti i Edukimit 3. Fakulteti i Biznesit 4. Fakulteti i Studimeve Profesionale	Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 1. Fakulteti i Shkencave Humane 2. Fakulteti Ekonomik 3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike 4. Fakulteti i Shkencave Natyrore 5. Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 1. Fakulteti i Shkencave Humane 2. Fakulteti i Ekonomisë 3. Fakulteti i Shëndetit Publik 4. Fakulteti i Shkencave Teknike	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 1. Fakulteti i Drejtësisë 2. Fakulteti Ekonomik 3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit 4. Fakulteti i Shkencave Shoqërore 5. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Gjatë përcaktimit të metodologjisë së mbledhjes së të dhënave, u morën parasysh disa modele. U vlerësua si e papërshtatshme hedhja e një pyetëso të tillë online ku mund të kenë akses një publik më i gjerë dhe provueshmëria e rezultateve ishte më e vështirë.

Më konkretisht për realizimin e këtij anketimi u ndoq kjo metodologji:

Të dhënat janë mbledhur duke intervistuar studentët e fakulteteve të përmendura më sipër, të cilët janë nga degë, vite dhe nivele të ndryshme studimi. Gjatë anketimit është marrë parasysh shpërndarja e rastësishme e pyetësorëve nëpër klasat e ndryshme në çdo fakultet dhe universitet, si dhe është siguruar asistenca e nevojshme nga koordinatorët dhe lehtësuesit e procesit për ata studentë të cilët kishin paqartësi.

Metodat e aplikuara në funksion të zbatimit të metodologjisë janë metoda sasiore të fokusuar në statistikat deskriptive të fenomenit. Përcaktimi i numrit të kampionit të marrë në studimin tonë është

realizuar duke u mbështetur në totalin e e studentëve Bachelor në vitin akademik 2018-2019 (gjithsej si në tabelën 1).

Në këtë studim jemi kujdesur që të sigurojmë një gabim të zgjedhjes prej 2.2 %, i cili konsiderohet shumë i pranueshëm në kushtet për të përgjithësuar rezultatin e gjetur në nivel kombëtar për këto 4 Universitete Publike.


Mbështetur në konceptin statistikor të gabimit $\Delta = z \cdot \sqrt{\frac{p(1-p)}{n}} \sqrt{\frac{N-n}{N-1}}$ dhe në informacionin në lidhje me totalin e studentëve në Bachelor (siguruar nga vetë Universitetet - tabela 1) rezultoi një volum kampionimi prej 1799 studentësh në total ndarë si më poshtë:

Universiteti	Popullimi (N)		Kampioni (n)	
	Nr. Studentësh	Përqindja (%)	Nr. Studentësh	Përqindja (%)
“Aleksandër Moisiu”, Durrës	11022	36	514	28.6
“Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	11480	37.4	481	26.7
“Ismail Qemali” Vlorë	5778	18.8	451	25.1
“Luigj Gurakuqi” Shkodër	2412	7.8	353	19.6
Totali	N=30692	100	n= 1799	100

4. ANALIZA E TË DHËNAVE TË ANKETIMIT

4.1 Informacion i përgjithshëm mbi të dhënat e të anketuarve

Lidhur me përqëndrimin e mbledhjes së të dhënave, nga 1799 pyetësorë ka rezultuar se pjesa më e



madhe e studentëve të anketuar i përket Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës me 28.57 % të totalit të ndarë në 4 fakultete², duke vijuar Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, i cili përbën 26.74% të të anketuarëve, të shpërndarë në 5 fakultete³, i ndjekur nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë me 25.07 % me shpërndarje në 4 fakultete⁴, si dhe me një përqindje më të ulët në nivelin 19.62 % përfaqësohet Universiteti “Luigj Gurakuqi” në

Shkodër, shpërndarja e të cilës është bërë në 5 fakultete të ndryshme.⁵


² Shih Fig.2

³ Shih Fig.3


⁴ Shih Fig.4

⁵ Shih Fig.5

Sa i takon vitit të studimit në të cilin studiojnë të anketuarit, KShH është përpjekur të sigurojë një balancë dhe përfaqësim të të 3 viteve të studimit në sistemin Bachelor, me qëllim identifikimin e treguesve konkretë për secilin target grup, që prej vitit të parë të studimeve, ku përgjithësisht studentët kanë një informacion të kufizuar, deri në vitin e tretë të studimit ku niveli i informimit për shkak edhe të eksperiencës gjatë 3 viteve është rritur. Kështu, 32.24 % e të gjithë studentëve të anketuar ndjekin studimet në vitin e parë në nivelin bachelor, 29.91% në vitin e dytë dhe 37.85% ndjekin studimet në vitin e tretë në nivelin bachelor të Universiteteve në të cilët është kryer anketimi.




Ndërkohë, lidhur me gjininë e të anketuarve, evidentohet se pjesa më e madhe tyre i përketin gjinisë femërore në një përqindje prej 79.43% kundrejt 20.57% studentëve meshkuj të anketuar.



4.2 Aktivizimi i studentëve në veprimtari ekstra-kurrikulare dhe anëtarësia në struktura/lëvizje studentore dhe OJF

Një aspekt tepër i rëndësishëm që ndihmon në rritjen e rezistencës dhe reagueshmërisë së studentëve ndaj korrupsionit është edhe aktivizmi i tyre në aktivitete dhe nisma ekstra kurrikulare, organizatorë të të cilave mund të jenë organizata të ndryshme, rrjete të ndryshme studentësh, etj. Këto aktivitete rrisin protagonizmin e studentëve duke i fuqizuar ata edhe në aspekte të tjera, pavarësisht fushës së interesit të tyre.



Nga raportimi rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve, e përfaqësuar në një nivel prej 86.55%, nuk janë të anëtarësuar në lëvizjet studentore, senat, struktura të tjera studentore, OJF, rrjete ndërkombëtare, etj. Anketimi paraqet një sistuatë shqetësuese lidhur me angazhimin e studentëve në struktura apo lëvizje studentore, ku respektivisht, vërtetë 3.61% e të anketuarve bëjnë pjesë në lëvizje studentore dhe 2.33 % në struktura si Këshilli Studentor. Nga ana tjetër evidentohet se pjesëmarrja

e tyre në Organizatat Jofitimprurëse shfaqet në nivele tepër të ulta përkatësisht me 2.17%.

Në vijim, mbetet pothuaj i papërfillshëm niveli i përfshirjes së studentëve në rrjete ndërkombëtare studentore (0.2%), të cilat kanë si qëllim kryesor shkëmbimin e përvojës dhe informacioneve apo ngritjen e kapaciteteve. Në përfundim, përqindjet e ulëta për anëtarësime ose pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme ekstra-kurrikulare nga të rinjtë në Durrës, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër tregojnë për mungesën e interesit të tyre për tu angazhuar në këto struktura, që mund të vijë si pasojë e mundësive të pakta, aksesit të kufizuar ndaj këtyre strukturave, mungesës së funksionimit efektiv të tyre, etj.

4.3 Njohja e studentëve me legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e sistemit të lartë arsimor'

Një tjetër element i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në ushtrimin e të drejtave të studentëve edhe njohja me kuadrin ligjor rregullues të organizimit dhe funksionimit të sistemit të lartë arsimor. Njohja me këtë legjislacion ndikon në rritjen e përdorimit të tyre nga studentët, duke siguruar edhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së strukturave të Universitetit. Ekspertët e angazhuar në këtë vërtetim, me anë të Seksionit I të pyetësorit të titulluar **“Legjislacioni për Arsimin e Lartë, informimi dhe përdorimi i tij nga studenti”**, realizuan matjen e nivelit të dijenisë dhe përdorimit të këtyre dokumenteve të rëndësishme nga studentët.


Është për t'u vlerësuar që përgjithësisht studentët e anketuar në të gjithë universitetet e përfshira në studim shohin një raport tepër pozitiv mes zotërimit të informacionit ligjor dhe të ndjerit konfident me institucionin e tyre universitar në aspektin e ushtrimit të të drejtave dhe respektimit të përgjegjësisë studentore.



Kështu, Rregulloret e Brendshme të Universitetit renditen si të parat në ndikim pasi kanë përqindjen më të madhe të njohjes nga studentët e anketuar. Konkretisht, 59.8 % e të anketuarve shprehen se i njohin më mirë përgjegjësitë e tyre me anë të rregullore, përkundrazi 51.8 % të studentëve që shprehen se njohuritë mbi këtë dokument i ndihmojnë ata në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Kodet e etikës renditen të dytat në ndikim. Njohuritë e studentëve lidhur me parashikimet e këtyre kodeve u vërejtën tek 42.9% e të anketuarve, çka shkon pothuajse në mënyrë proporcionale me ushtrimin e të drejtave të studentëve (43.3%), ndërkohë që vetëm 23% e studentëve e kanë përdorur Kodin për të zgjidhur problemet e tyre në jetën studentore. Anketimi evidenton se 1 në 6 studentë pohojnë se kanë njohuri për Ligjin për Arsimin e Lartë. Rreth 1 në 2 studentë ka njohuri të interpretueshme mbi Ligjin e Arsimit të Lartë. Shqetësues është fakti që 1 në 4 studentë pohon se nuk e njeh fare Ligjin për Arsimin e Lartë. Ndikimi i njohurive mbi Ligjin e Arsimit të Lartë sjell një konfidencë të vlerësueshme për 1 në 4 studentë të universiteteve sikurse 1 në 4 studentë pohojnë se nuk ndikohen në konfidencën me “fakultetin” nga fakti nëse kanë njohuri për LAL.

Studentët u pyetën gjithashtu për burimin nga e kanë marrë informacionin për aktet rregullatore dhe ligjore të arsimit të Lartë. Kështu rezultoi se, 1 në 4 studentë kanë marrë informacion për kodin etik me anë të faqeve të internetit të universiteteve dhe fakulteteve. Më shumë se 40% e studentëve




referuan se këto faqe internet nuk përdoren si burim informacioni për të marrë njohuri mbi Ligjin për arsimin e lartë. Situata është më e përmirësuar në përdorimin e faqeve zyrtare të internetit të Fakulteteve/Universiteteve për të njohur Rregulloren e Brendshme nga 1 në 3 studentë, dhe pothuajse në të njëjtën kuotë të anketuar përdorin edhe burime të tjera për të marrë informacion.

Nga kryqëzimi i Seksionit “Legjislacioni për Arsimin e Lartë, informimi dhe përdorimi i tij nga studenti” me cilësinë e të anketuarve në të qenit “anëtar”, rezulton se anketimi sjell rezultate tepër pozitive për bashkësinë e studentëve të anketuar që pranojnë se janë anëtarë të strukturave studentore si Këshilli Studentor (2.33%) ndaj zotërimit të paketës juridike universitare (Ligj, Rregullore, Kod Etik). Kjo kategori, edhe pse në përqindje të ulët me numrin total të studentëve të anketuar, beson se me anë të këtij kuadri ligjor mund të ushtrojnë të drejtat e tyre. Për këtë bashkësi përdorimi i Kodit Etik për zgjidhjen e problemeve studentore rezulton të jetë më i lartë. Bashkësia e të intervistuarve që pranojnë se janë anëtarë të Lëvizjeve Studentore (3.61%) krijon epërsi në zotërimin e njohurive për Ligjin e Arsimit të Lartë dhe ushtrimin e të drejtave studentore.

4.4 Barazia në mundësi dhe procedura

Me qëllim evidentimin e të dhënave lidhur me fenomenet korruptive në arsimin e lartë që prej fazave të hershme të kontaktit të studentëve me universitetin, seksioni II i pyetjeve “Aplikimet dhe universiteti/fakulteti” mat vlerësimin e studentëve për “barazinë e mundësive dhe procedurave” që ofron arsimi i lartë në këto institucione. Ligjërisht, të gjithë studentët duhet të kenë mundësi të barabartë dhe në mënyrë të ndershme për të patur akses në të mirën e dëshiruar prej tyre, duke marrë parasysh pozicionet e ndryshme të fillimit.

Aplikimet dhe universiteti/fakulteti



Nga anketimi evidentohet se 1 në 3 studentë vlerësojnë se respektohet barazia në procedurat e aplikimit në universitete. Është pozitiv fakti që shumatorja e studentëve që kanë përzgjedhur alternativën “Plotësisht dakord”, “Shumë dakord” dhe “Dakord” sa i takon barazisë në procedurat e ndjekura nga universiteti/fakulteti është në nivele të larta, përkatësisht në masën 72.4 % të të anketuarve ose më shumë se 2 në 3 të anketuar.

Afro 2 në 3 studentë ose 73.3% e të anketuarve vlerësojnë garantimin e barazisë në procedurat e regjistrimit në bibliotekat e fakulteteve ndërsa shprehen me “Plotësisht dakord”, “Shumë dakord” dhe “Dakord”. Afër 20% e studentëve të anketuar kanë kritika për mosgarantimin e barazisë për intershipe që ofron fakulteti (2.N), projekte kërkimore (2.O) dhe për bursa jashtë Shqipërisë (2.P) pasuar kjo pothuajse me të njëjtin qëndrim kritik për këshillimin e karrierës dhe pjesmarrjen në Konferenca Shkencore.


Ky qëndrim reflekton edhe qëndrimin e studentëve të shfaqur gjatë aktiviteteve të tjera të kësaj nisme, ku është pohuar se mundësi të tilla, veçanërisht për bursat Erasmus+, janë preferenciale dhe shpesh ata nuk marrin dijeni për hapjen e thirrjeve për të aplikuar, duke humbur kështu edhe shanset për tu përzgjedhur më tej.

4.5 Transparenca

Transparenca në universitet është një element thelbësor në mbarëvajtjen e jetës studentore. KShH, në seksionin III, ka marrë në analizë aspekte të ndryshme të kurrikulës universitare, e cila është përkufizuar gjerësisht si tërësia e përvojave të studentëve që realizojnë gjatë procesit të cikleve të ndryshme gjatë studimeve akademike.⁶

Kështu, nga rezultatet e anketimit evidentohet se transparenca merr vlerësimin të lartë, me 60.8% e të anketuarve të cilët pohojnë se njohuritë për kurrikulën e degës ku studiojnë i kanë përfituar gjatë studimeve të tyre, pasuar nga nga 56.1% e studentëve të anketuar të cilët shprehen se i njohin programet e kurseve gjatë një viti akademik.

Transparenca në kurrikulën universitare




Ka një përqindje të lartë të studentëve të anketuar (prej 43,1%) të cilët pohojnë se nuk përdorin literaturë të hapur⁷ për përgatitjen e tyre në kurset akademike, ndërkohë që 1 në 3 studentë pranojnë se përdorin literaturë të detyruar nga pedagogu i lëndës në përgatitjen për kursin. Më pak se 1 në 5 studentë pranojnë se përdorin tekste me ISBN të deklaruar, përkundrajt 41.1% të tyre të cilët janë disi dakort me pohimin duke pohuar se përdorimi i teksteve me ISBN të deklaruar nuk ndodh gjithmonë. 31% e të anketuarve shprehen se tekstet akademike që përdorin kanë çmim të deklaruar,

⁶ Termi shpesh i referohet në mënyrë specifike një përmbajtje të planifikuar akademike (module, kurse disiplinash universitare-leksion dhe seminare, praktika mësimore) shtrirë këto në Bachelor dhe vitet përkatëse, Master dhe vitet përkatëse.


⁷ Termi “literaturë e hapur” është përdorur për rastet kur është studenti që vendos mbi tekstin referues në literaturën e programuar

përkundrejt 38.8 % të tyre që shprehen se janë disi dakord me pohimin që lë të kuptohet se deklarimi i çmimit nuk ndodh gjithmonë.

Problematic është fakti se tekstet akademike shpesh nuk kanë çmime favorizuese (speciale) për studentët. Kështu, pothuajse 1 në 2 studentë të anketuar (46.3 %) pohon se nuk përdor tekste me çmim preferencial për studentët, përkundrejt 1 në 5 studentë të cilët pohojnë se tekstet akademike që përdorin kanë çmime speciale për studentët.



Nga kryqëzimi i të dhënave “Transparenca e kurrikulës universitare” me “universitetin ku studiojnë të anketuarit” rezultojnë se: Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, ka epërsi në transparencën kurrikulare në elementët e tabelës mbi të tjerët. Në vendin e dytë është Universiteti “Ismail Qemali”, ndërkohë që Universiteti i Elbasanit dhe Shkodrës qëndrojnë në pothuajse të njëjtin nivel për secilin indikator. Megjithatë të katër universitetet janë mbi mesataren e vlerësimit.




Universiteti i Elbasanit cilësohet nga të anketuarit si universiteti që përdor më shumë çmimet favorizuese për studentët, i ndjekur nga Universiteti i Vlorës. Ndërkohë Universiteti i Durrësi ka epërsi në përdorimin e teksteve akademike me çmim dhe ISBN të deklaruar, por edhe në përdorimin e literaturës së detyruar nga pedagogu. Problematike për studentët mbetet përdorimi i literaturës së detyruar nga pedagogët duke sjellë një

epërsi të saj mbi përdorimin e literaturës së hapur.

4.6 Orari mësimor dhe skema e vlerësimit të studentëve


Sipas të anketuarve, rreth 40.4% vlerësojnë se orari mësimor i deklaruar në fillim të semestrit për kurset e lëndëve respektohet nga çdo pedagog lënde, ndërkohë që 36.9% shprehen disi dakord dhe

Transparenca në kurrikulën universitare²



pothuajse 1 në 5 studentë shprehen aspak dakord duke vlerësuar se orari mësimor i deklaruar në fillim të semestrit nuk respektohet nga çdo pedagog, për arsye të ndryshme.

Një çështje tjetër që shpesh shqetëson studentët është vlerësimi i tyre gjatë seminareve apo marrja dijeni për pikët e këtyre të fundit. Kështu, 37.4% e studentëve të anketuar shprehen se njohin publikisht cilësinë e vlerësimit në seancat e seminareve ku janë aktiv. Ndërkohë që 1 në 5 studentë shprehin të kundërtën. Pjesa tjetër rreth 40.7% shprehen disi dakord duke treguar se jo gjithmonë njihen publikisht me vlerësimin në seancat e seminareve ku janë aktiv. Nga ana tjetër rreth 42.4% e të anketuarve njohin vlerësimin për seminare dhe detyra të ndërmjetme para çdo provimi për kursin e lëndës, një masë e konsiderueshme rreth 39.1% shprehen disi dakord me këtë pohim dhe 18.5% e të anketuarve shprehen aspak dakord duke mohuar njohjen e vlerësimit për seminare dhe detyra të ndërmjetme para çdo provimi për kursin e lëndës.




Anketimi evidenton një situatë pozitive lidhur me transparencën e politikave të vlerësimit, ku kryeson Universiteti i Durrësit, ndjekur nga ai i Vlorës, Shkodrës dhe me pak diferencë me atë të Elbasanit por të gjitha vlerësohen mbi mesataren.

Një aspekt që shpesh herë është konsideruar problematik është edhe sekretimi i provimeve të studentëve me qëllim shmangien e çdo favorizimi apo konflikti

interesi të mundshëm. Lidhur me këtë tregues evidentohet se 20.6% e të anketuarve shprehen se nuk ndodh procesi i sekretimit në çdo provim ku bëhet vlerësimi përfundimtar, përkundrejt pjesës tjetër përkatësisht 31.4%, të cilët shprehen plotësisht dakord se sekretimi ndodh në çdo vlerësim përfundimtar. Ndërkohë 47.7% e studentëve të anketuar shprehen disi dakord, duke treguar se jo gjithmonë ndodh procesi i sekretimit për provimet e vlerësimit përfundimtar për kursin e lëndës.

Rëndësi kanë edhe të dhënat e anketimit për procesin e rishikimit apo ballafaqimit të studentëve me pedagogët për vlerësimet në provime. Përgjigjet e dhëna evidentojnë problematikë në këtë drejtim, pasi 41.7% e studentëve të anketuar janë shprehur se nuk kanë përfituar aspak nga procesi i rishikimit të notës së vënë nga pedagogu. Një masë e konsiderueshme e studentëve, rreth 32.6% shprehen disi dakord me pohimin, duke lënë hapësirë për interpretimin e këtij vlerësimi, se jo gjithmonë ata kanë përfituar nga procesi i rishikimit, përkundrejt 25.7 % apo 1 në 4 studentë të cilët kanë pohuar se kanë përfituar nga ky proces.



Nga kryqëzimi i të dhënave për transparencën lidhur me përkatësinë në universitet, është për t'u vlerësuar niveli mbi mesatar në të gjitha këto procedura të transparencës kurrikulare universitare i të gjitha universiteteve, duke nxjerrë në pah lehtëzi epërsinë e pozitivitetit të vlerësimit për Universitetin e Durrësit, por edhe vlerësimin më të ulët për këto procedura në Universitetin e Elbasanit.

4.7 Kërkimi i favoreve seksuale nga pedagogët


Shpeshherë, një fenomen i cili është i vështirë për tu pranuar dhe denoncuar është edhe presioni për favore seksuale nga pedagogët karshi studentëve. Në anketimin e realizuar, KShH ka matur treguesin se sa ky fenomen ndikon në vlerësimin e studentëve. Kështu, 54.9% e studentëve të anketuar shprehen se marrin vlerësimin që meritojnë dhe se nuk kanë qenë viktimë të presioneve për favore seksuale. Lidhur me këtë pohim, vetëm 19% e të anketuarve shprehen disi dakord duke lënë hapësirë për interpretim se ky fenomen mund të ndodhë ndonjëherë ndërkohë që 26.1% e të anketuarve se kanë qenë viktimë i kërkesave apo presioneve nga pedagogët për favore seksuale në këmbim të notës.

Universiteti i Elbasanit merr një vlerësim më të ulët për sa i përket pohimit se studentët vlerësohen


me notën që meritojnë larg presioneve për favore seksuale. Kjo problematikë u evidentua edhe gjatë aktiviteteve të tjera të kësaj nisme, ku studentët e universitetit “Aleksandër Xhuvani” nuk hezituan të diskutonin për raste ku vetë ata apo miq të tyre ishin bërë subjekt i kërkesave për favore seksuale nga pedagogët e tyre.

4.8 Aksesi i studentëve në dokumentacion

Treguesi përgjegjësisë së institucioneve të arsimit të lartë është edhe gatishmëria e tyre për të pajisur studentët me dokumentat e nevojshëm brenda një afati të arsyeshëm. Anketimi evidentoi se 31,5% e studentëve shprehen se janë dakord me pohimin se kanë zotëruar brenda afateve të deklaruara për përgatitje, çdo dokument që kanë kërkuar pranë fakultetit / universitetit. Një numër i konsiderueshëm i studentëve, rreth 44.2% shprehen disi dakord me këtë pohim, duke nënkuptuar që jo gjithmonë i kanë marrë dokumentat e kërkuar brenda afateve të deklaruara për përgatitje. Nga ana tjetër 1 në 5 studentë ose 24.3% e të anketuarve vlerësojnë se kërkesat e tyre për dokumentacion nuk janë plotësuar brenda afateve të nevojshme për përgatitjen e tyre nga fakultetet përkatëse.



Vendosja në dispozicion të studentëve, të dokumentacionit të nevojshëm sipas akteve rregullatore, rezulton në linja mbi mesataren në të katërta universitetet.





4.9 Transparenca në raport me anëtarësinë në rrjete dhe struktura studentore

Nga analiza e të dhënave të kryqëzuara të transparencës me cilësinë e të qenit “anëtar” rezulton se studentët e anketuar që janë anëtarë të Rrjeteve Ndërkombëtare të Studentëve, Lëvizjeve Studentore apo Strukturave studentore kanë një konfidencë të shprehur me institucionin përmes zotërimit të informacionit rreth kurrikulës universitare.

Masa më e madhe e studentëve të anketuar, ajo e paanëtarësuar, 86.55%, mban nivelet më të ulta të vlerësimit për shkallën e transparencës me tekstet akademike, por megjithatë këto të dhëna janë mbi mesataren e vlerësimit.

Siç vërehet nga grafikët, anëtarët në Organizata Studentore kanë qasje kritike dhe pohojnë fort fenomenin e përdorimit të literaturës së detyruar nga pëdagogët.


Përkundrejt kësaj panorame, anëtarët studentë të Senateve pohojnë një optimiste, pasi perceptimet e tyre janë më shumë pozitive se të anketuarit e tjerë, në raport me transparencën me



seminareve por të gjithë bashkë të anketuarit kanë një vlerësim mbi mesataren për transparencën e vlerësimit nga pëdagogët.

tekstet akademike (literature e hapur, tekste me ISBN, me çmim të deklaruar dhe me çmime speciale për student). Më kritikë në vlerësim (në vlerat më të ulta) janë studentët e anketuar, anëtarë të Organizatave Studentore.


Të anketuarit që bëjnë pjesë në Rrjetin Ndërkombëtar Studentor kanë nivelet më të larta të vlerësimit për transparencën e sistemit të vlerësimit në procesin mësimor. Më kritikët shprehen anëtarët studentë të Senatit në vlerësimet gjatë



4.10 Përfaqësimi dhe aktivizimi i studentëve në Këshillat Studentor dhe në Senat

Këshilli Studentor është një hallkë e rëndësishme në jetën studentore. Këshilli Studentor është një organizim i pavarur studentor i atashuar dhe në bashkëpunim të plotë me institucionin e lartë arsimor ku operon. Funksionimi i Këshillit Studentor bazohet në Ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 99. Kështu, Këshillat Studentorë promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë. Ka një sërë parashikimesh për funksionimin e tyre, të cilat janë reflektuar në Seksionin IV të pyetësorit me qëllim matjen e treguesve të ndryshëm për evidentimin e problematikave kryesore që hasen në universitetet ku është kryer anketimi.

Të anketuarit shprehen përgjithësisht kritik për procesin e zgjedhjeve në Këshillat Studentore dhe strukturat studentore të zgjedhura. Pjesa më e madhe, 58.8% e studentëve shprehen se nuk kanë informacion dhe dijeni sa herë zhvillohen zgjedhjet për këshillat studentorë, përkundrejt 17.4% e të anketuarve, ose pothuajse 1 në 6 studentë, të cilët shprehin dijeninë e tyre për sa më sipër. Nivele të njëjta vlerësimi paraqiten edhe për njohjen e përfaqësuesve në radhët e studentëve në Senatin e Universitetit dhe Këshillin Studentor në fakultetin e tyre. Konkretisht, 56.9% e studentëve të anketuar shprehen se nuk kanë informacion se cilët janë përfaqësuesit e tyre në Këshillin Studentor, mbështetur kjo edhe me vlerësimin prej 57% që të anketuarit bejnë për njohjen e studentëve senator në Senatin e Universitetit. Respektivisht, vetëm 1 në 5 studentë i njohin përfaqësuesit e tyre në Këshillin Studentor përkundrejt nivelit të 1 në 6 studentë që njeh përfaqësuesit e tyre në Senat.



Mungesa e dijenisë për 3 treguesit e mësipërm⁸ pasqyron rrjedhimisht edhe aksesin e kufizuar të të anketuarve në njohjen e platformave të kandidatëve, çka mund të rezultojë në shkelje të procedurave dhe parashikimeve të Ligjit, statuteve përkatëse rregullatore të një procesi të tillë, të rëndësishëm përfaqësimi. Në vijim, studentët e anketuar janë shprehur në masën 45,2% se nuk kanë mundësi të kandidojnë lirisht si përfaqësues të Këshillit studentor sa herë bëhen zgjedhje në Fakultet. Pavarësisht se kjo shifër është shqetësuese në tërësi, nga ky anketim nuk evidentohen arsyt kryesore për këtë rezultat, i cili mund të jetë për shumë shkaqe, duke filluar nga mosplotësimi i kriterëve për kandidat, mungesa e informacionit apo mënyra jo e rregullt e realizimit të procesit.


Nga anketimi por gjithashtu nga diskutimet gjatë takimeve dhe akademive të organizuara me studentët rezulton se përceptimi i studentëve për ndikimin e faktorëve të ndryshëm në zgjedhjet e Këshillave Studentorë dhe përfaqësuesve të Senatit është relativisht mesatar. Kështu, vlerësohet se ndikimin më të konsiderueshëm e kanë pedagogët dhe stafet drejtuese të fakulteteve, e pohuar kjo gjithashtu nga 28.2 % e studentëve të anketuar për pedagoget dhe 28.6 % e të anketuarve për stafin

⁸ 1. Zgjedhjet e Këshillave Studentorë; 2. Përfaqësuesit e tyre në Këshill Studentorë; 3. Përfaqësuesit në Senatin e Universitetit

drejtues. Sipas nenit 99, pika 4 të ligjit 80/2015, “Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë”. Referuar përgjigjeve të dhëna nga 43.4% e të anektuarve, partitë politike ndikojnë në një nivel të ulët tek Këshillat Studentorë, ndërkohë që 32% e studentëve janë të dyzuar në përgjigjen e tyre. Megjithatë, 1 në 4 studentë pohon se partitë politike ndikojnë dhe përfshihen në procesin e zgjedhjes së Këshillave Studentore, çka përbën një të dhënë shqetësuese.

Lidhur me aktivitetin e Këshillave Studentore⁹, një pjesë e konsiderueshme e studentëve të anketuar, konkretisht 47,7% e tyre pohojnë se nuk janë të kënaqur me punën që bëjnë Këshillat, ndërkohë që vetëm 1 në 5 studentë pranon se Këshillat Studentorë bëjnë një punë të mirë.

Sa i takon efikasitetin të veprimtarisë së Këshillave në mbrojtjen e interesave të studentëve, pothuajse 1 në 4 studentë të anketuar e mbështesim këtë pohim, përkundërt 39.1% të tyre të cilët e kundërshtojnë duke pohuar se Këshillat Studentorë nuk realizojnë aktivitete në mbrojtje të interesave të studentëve. Nga kryqëzimi i informacioneve u vërejt se në të katër universitetet ka një vlerësim mbi mesatar për punën e Këshillave Studentorë në zhvillimin e veprimtarive në mbrojtje të interesave të studentëve. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë vlerësohet më mirë përse i përket punës së Këshillave Studentorë, njohjes së studentëve me platformat e kandidatëve për këtë strukturë, mundësitë për të vetëkandiduar, informimit për zgjedhjet e Këshillave Studentorë, etj. Ndërkohë që për treguesit e tjerë si mungesa e ndikimit të partive politike, pedagogëve apo stafit drejtues të Fakultetit në zgjedhjet për Këshillat Studentorë, rezultojnë të ketë marrë vlerësim më të mirë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës. Nga ana tjetër, ky Universitet ka marrë vlerësimin më të ulët, i ndjekur nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, sa i takon transparencës në procesin e realizimit të zgjedhjeve të Këshillave, niveli i ulët i mundësisë së studentëve për të kandiduar, njohjes se platformave të kandidatëve, si dhe përfaqësuesve të tyre në Senatin e Universitetit apo në Këshillin Studentor. Sa i përket ndikimit të partive politike në zgjedhjet në fakultet, rezultojnë se ky ndikim është më i lartë në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, i ndjekur nga universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan.




⁹ “Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.”

4.11

Qëndrimi i studentëve ndaj korrupsionit


Studentët shpesh, edhe nëse nuk janë prekur apo përfshirë në veprimet korruptive, arrijnë të krijojnë një përceptim për nivelin e korrupsionit në arsimin e lartë nisur nga përvojat e miqve të tyre studentë. Me anë të seksionit VI “**Studenti rezistent ndaj korrupsionit dhe besueshmëria në institucionalizmin universitar**” u synua të evidentoheshin sjelljet korruptive tek studentët e anketuar, si dhe miqtë e tij studentë.



Në vlerësimin e vetes apo miqve si studentë rezistentë ndaj fenomeneve korruptive vërehet se të anketuarit e vlerësojnë veten pothuajse dyfish më rezistent ndaj korrupsionit sesa miqtë e tyre.

76.4% të studentëve të anketuar referojnë se janë “Dakord”, “Shumë dakord” dhe “Plotësisht dakord” me pohimin se e vlerësojnë veten si student rezistent ndaj fenomeneve korruptive në arsimin e lartë në vend, ndjekur nga 77.2% e të anketuarve të cilët kanë të njëjtat përgjigje ndaj fenomeneve korruptive në universitetin ku studiojnë dhe 75% e të anketuarve studentë kanë të njëjtat përgjigje ndaj fenomeneve korruptive në fakultetin e tyre. Vlerësimi i miqve si rezistentë ndaj korrupsionit ka rezultuar të jetë më i ulët, ku përkatësisht 67.9% e të anketuarve pohojnë se i vlerësojnë miqtë e tyre si rezistentë ndaj akteve korruptive në arsimin e lartë në vend. Gjithashtu 67.8% e të anketuarve studentë i vlerësojnë miqtë e tyre si studentë rezistentë ndaj korrupsionit në universitetin ku studiojnë, me një diferencë prej 9.4% me vlerësimin për veten e tyre. Në vijim, 69.6% e të anketuarve i vlerësojnë miqtë e tyre si rezistentë ndaj fenomeneve korruptive në fakultetin e tyre duke evidentuar një diferencë prej 5.4% e të anketuarve.


Lidhur me rezistencën e studentëve ndaj akteve korruptive në tabelën e kryqëzuar më poshtë evidentohen të dhënat e lidhura me universitetin të cilit i përkasin të anketuarit. Studentët në të katër universitetet kanë një vlerësim mbi mesatare me kah drejt pozitives për aftësinë e rezistencës studentore ndaj fenomeneve korruptive në arsimin e lartë ndërsa epërsi më të spikatur e kanë



vlerësimet për universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, ndjekur nga universiteti “Luigj Gurakuqi në Shkodër”. Përformancën më të ulët në vlerësim pothuajse në të gjithë treguesit, e ka Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.

4.12 Besimi tek integriteti i institucioneve

Me anë të seksionit VI “Besimi te integriteti i institucioneve” studentët kanë vlerësuar si mbështetësit e tyre kryesorë 3 institucione ku kryeson Dekani i fakultetit, Rektori i Universitetit dhe



Media. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e studentëve, kanë humbur besimin te institucionet e parashtruara në këtë seksion, shprehur kjo edhe nga vlerësimi duke e pozicionuar alternativën “Asnjë” në vendin e katërt.

5. REKOMANDIME

Korrupsioni në jetën akademike nuk është sporadik por i praktikuar dhe i përhapur prej kohësh. Nisma të tilla të cilat inkurajojnë vetë studentët për t'i luftuar dhe parandaluar këto fenomene janë të rëndësishme në çdo kohë në universitete, duke marrë parasysh natyrën “rigjeneruese” të këtij institucioni i cili çdo vit ka prurje të reja. KShH inkurajon modele pozitive të reagueshmërisë studentore në të gjitha Universitet në vend. Disa nga rekomandimet që mendojmë se vlejné për të adresuar problematikat e identifikuara në kuadër të nismës tonë janë si vijon:

- 1- I rekomandojmë universiteteve të përfundojnë hartimin e akteve dhe dokumentacionit ligjor që parashikohen në ligjin nr. 80/2015, në bazë universiteti dhe fakulteti.
- 2- Rekomandojmë *përfshirjen e demokracisë elektorale* si pjesë e Statutit, Rregullores, Kodit Etik ndërkohë që vlerësojmë shumë të rëndësishme hartimin e një Rregulloreje të Zgjedhjeve për Këshillat Studentore në nivel universiteti.
- 3- Rekomandojmë përfshirjen e detyrimit për hartimin dhe pajisjen e çdo studenti, qysh në momentin e aplikimit në universitetin përkatës, me Paketën e Studentit (nominale) që synon njohjen e studentit me kuadrin ligjor të institucionit (Ligji IAL, Statut, Rregullorja e brendshme, Kodi i Etikës, Rregullorja e Zgjedhjeve, etj). Pjesë e kësaj pakete mund të jenë edhe “Kazuset studentore” që do aftësonin studentët për tu praktikuar dhe përfshirë në jetën e përditshme akademike.
- 4- I rekomandojmë universiteteve të prezantojnë dhe të bëjnë transparente instrumentet e komunikimit me studentët që do të çonin në evidentimin dhe bërjen publike të ndryshimeve të dokumentave të mësipërm. Kjo do të kontribuonte në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së strukurave drejtuese të univesiteteve apo fakulteteve, njëkohësisht do t’iu japë studentëve mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre më mirë. Forcimi i këtyre elementëve në IAL do të nxisë rritjen e integritetit dhe parandalimin e akteve korruptive.
- 5- I rekomandojmë universiteteve krijimin në ambientet e dukshme të fakulteteve të **“Këndit të Lëgjisllacionit Universitar”**, pranë Zyrave të Informacionit si dhe të **“Këndit Elektoral”** për proceset e ndryshme zgjedhore në institucion. Këto kënde mund mund të shfhtëzohen nga studentët dhe stafet e fakultetit/universitetit.
- 6- Ndërsa vlerësojmë arritjet e deritanishme, rekomandojmë gjetjen e instrumenteve elektorale të reja që garantojnë votën e lirë dhe të ndershme në Këshillat Studentorë. Rritja e transparencës, qysh në procesin e aplikimit, zgjedhjet e anëtarëve dhe funksionimit të Këshillave do të rriste besimin e studentëve në këtë strukturë dhe do të shërbente si faktor i rëndësishëm dhe një mjet efektiv për përfshirjen dhe adresimin e problematikave të studentëve në vendimarrjen e IAL.
- 7- Rritja e transparencës dhe bashkëpunimit të Qëndrave të Karrierës me studentët për sigurimin e mundësive të barabarta për përfitimin e praktikave profesionale, bursave të studimit, pjesëmarrjes në konferenca për të gjithë studentët vlerësojmë se mund të shoqërohet ofrimin e informacionit me anë të një sërë burimesh, jo vetëm në fazën e hapjes së aplikimeve por për të gjithë procesin nga fillimi dhe deri në përfundim të tij (si psh, sa studentë aplikuan, kush fitoi, me cilin universitet, partnerët e huaj, nëse u vendosën ura bashkëpunimi, vlerësimet e përfituesve nga këto mundësi, vlerësime të zyrave të huaja të bashkëpunimit për studentë dhe pedagogët që përfituan në programe të tilla, etj).
- 8- Teksa vlerësojmë progresin institucional për standardin e cilësisë dhe transparencës në elementë të kurrikulës universitare, duke nxitur edhe nga problematikat e evidentuara gjatë

“Coffe Hours” me studentët, KShh rekomandon prezantimin e një standarti të ri në jetën universitare që ofron *mundësinë e zgjedhjes së lirë të materialit* që do të përdoret nga studenti në përgatitjen akademike përkundrejt literaturave opsionale të syllabuseve të përgatitura nga titullarët akademike të lëndës.

- 9- Përdorimi i librave të liçensuar në procesin mësimor, me çmim të deklaruar dhe preferencial për studentët rekomandojmë se mund të forcohet sikurse rekomandohet që vetë pedagogët autorë (të brendshëm apo të jashtëm) të mund të *dhurojnë minimalisht deri në 5 kopje të librit pranë bibliotekës së fakultetit* përkatës ku përdoret teksti.
- 10- Rekomandojmë përfshirjen më shumë në kurrikulën universitare të njohurive mbi kulturën, etikën e *pronësisë intelektuale* dhe cilësimit të plagjiaturës në produkte studentorë dhe akademike.
- 11- Rekomandojmë përmbushjen e detyrimeve ndaj studentëve për njohjen e tyre me vlerësimin nga seancat e seminareve dhe vlerësimin e detyrave në grup apo individuale gjatë procesit lëndor, kjo, para provimeve.
- 12- Rekomandojmë forcimin edhe më tej të sjelljes institucionale për përmbushjen e detyrimeve për transparencës gjatë provimeve, përmes një procesi sekretimi, sipas procedurave të përcaktuara në Rregullore. Vlerësojmë se transparenca do të garantohej cilësisht nëpërmjet prezantimit dhe mirëfunksionimit të një *sistemi online* për vlerësimin e provimeve.
- 13- Rekomandojmë krijimin një *seksioni në faqet zyrtare të fakulteteve*, ku studentët anonimisht mund të paraqesin ankesat e tyre për raste të ndryshme të sjelljeve joetike dhe akteve korruptive në jetën universitare.
- 14- Rekomandojmë që të prezantohen dhe aplikohen forma efektive të kontrollit dhe vlerësimit të brendshëm në universitete si psh përmbushja e *instrumentave të anketim vlerësimit* që mundëson monitorimin e stafit administrativ për rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies për plotësimin e kërkesave të studentëve, në përputhje me afatet e përcaktuara, këto të parashikuara nga Ligi si pjesë e vlerësimit të brendshëm të institucionit universitar.

ANNEX I – Pyetësi

Ky pyetësor synon të vlerësojë nivelin e integritetit të institucionit universitar nga perceptimet dhe vlerësimet e studentëve. Në rrafshin institucional integriteti përbëhet nga disa karakteristika si: llogaridhënia, transparenca, rezistenca ndaj korrupsionit, etika dhe ndershmëria, efikasiteti dhe profesionalizmi i administratës që shërben në të. Në vetvete synohen të maten përpjekjet shtetërore (qeverisje, institucione universitare, institucione studentore, shoqëri civile etj) për të përmirësuar cilësinë e arsimit të lartë përmes shmangies së korrupsionit.

SEKSIONI I TË DHËNAVE

Universiteti: _____

Fakulteti ku studioni: _____

1. Niveli i studimeve: 1. Bachelor Viti: 1. I parë 2. I dytë 3. I tretë

2. Master Shkencor Viti: 1. I parë 2. I dytë

3. Master Profesional

2. Gjinia: 1. Femër 2. Mashkull

3. Mosha: 19-22vjeç 23-25vjeç 25-30vjeç 30-40vjeç mbi 40 vjeç

4. A jeni anëtar në: (qarko)

1. Struktura studentore (këshill studentor);
2. Senatin e universitetit;
3. Lëvizje studentore;
4. Organizatë Jo-fitmprurëse me fokus studentët (emërto)
5. Rrjet Ndërkombëtar Studentor;
6. Në asnjë prej tyre.

SEKSIONI I

Legjislacioni për Arsimin e Lartë, informimi dhe përdorimi i tij nga studenti.

Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

Ju lutem, vlerësoni nga 1 deri në 3, ku (1) është "Aspak dakord" ; (2) "Disi dakord"; (3) "Shumë dakord"

A. Unë kam njohuri për Ligjin për Arsimin e Lartë në RSH	1	2	3
--	---	---	---

B. Ligjin e kam njohur nga faqja elektronike e universitetit ku unë studjoj	1	2	3
C. Ligjin e kam njohur nga faqja elektronike e fakultetit ku unë studjoj	1	2	3
D. Ligjin e kam njohur nga burim tjetër (plotëso.....)	1	2	3
E. Duke e përdorur Ligjin unë ndjem konfident me Fakultetin	1	2	3
F. Rregulloren e kam njohur nga faqja elektronike e universitetit ku unë studjoj	1	2	3
G. Rregulloren e kam njohur nga faqja elektronike e fakultetit ku unë studjoj	1	2	3
H. Rregulloren e kam njohur nga burim tjetër (plotëso.....)	1	2	3
I. Duke e zotëruar Rregulloren unë ushtroj të drejtat e mia	1	2	3
J. Duke e zotëruar Rregulloren unë njoh përgjegjësitë e mia	1	2	3
K. Unë kam njohuri për Kodin Etik të Universitetit ku studjoj	1	2	3
L. Duke e zotëruar Kodin unë kam përdorur të drejtat e mia	1	2	3
M. Kodin e kam njohur nga faqja elektronike e universitetit ku studjoj	1	2	3
N. Kodin e kam njohur nga faqja elektronike e fakultetit ku studjoj	1	2	3
O. Kodin e kam njohur nga burim tjetër (plotëso.....)	1	2	3
P. Bazuar në Kodin etik kam zgjidhur probleme e mia në jetën studentore	1	2	3

SEKSIONI II.

Aplikimet dhe universiteti/fakulteti

Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

Ju lutem, vlerësoni nga 1 deri në 5, ku (1) është "Aspak dakord" ;; (2) "Disi dakord; (3) "Dakord"; (4) "Shumë dakord"; dhe (5) "Plotësisht dakord".

Shpjegim: "Barazia e mundësive" sygjeron që të gjithë individët duhet të kenë mundësi të barabartë për të fituar hyrje në të mirën e dëshiruar prej tyre, duke marrë parasysh pozicionet e ndryshme të startimit. Mundësia e barabartë synon shanse të barabarta por jo rezultate të barabarta.

A. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat e aplikimit për ndjekjen e universitetit	1	2	3	4	5
B. Vlerësoj garantimin e barazisë në sistemin e përzgjedhjes së fakultetit që kam dashur të studjoj në universitet	1	2	3	4	5
C. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat për regjistrimin në Bachelor	1	2	3	4	5
D. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat për regjistrimin në master shkencor	1	2	3	4	5
E. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat për regjistrimin në	1	2	3	4	5

master profesional					
F. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat për regjistrimin në bibliotekën e fakultetit	1	2	3	4	5
G. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat për regjistrimin në Bibliotekën Kombëtare (nëse keni përvojë)	1	2	3	4	5
H. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat për regjistrimin në Bibliotekën e Qytetit (nëse keni përvojë)	1	2	3	4	5
I. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat për regjistrimin në lëndët me zgjedhje	1	2	3	4	5
J. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat e aplikimit në aktivitete trajnuese	1	2	3	4	5
K. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat e aplikimit për pjesmarrje në Konferenca Shkencore	1	2	3	4	5
L. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat e aplikimit për këshillim karriere	1	2	3	4	5
M. Vlerësoj garantimin e barazisë së pjesmarrësve në procedurat e aplikimit për pjesmarrje në projekte kërkimore në fakultet	1	2	3	4	5
N. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat e aplikimit për pjesmarrje në projekte kërkimore në universitetin ku studjoj	1	2	3	4	5
O. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat e intershipëve që ofron fakulteti	1	2	3	4	5
P. Vlerësoj garantimin e barazisë në procedurat e aplikimit për aplikim në programet e bursave të ofruara nga jashtë Shqipërisë për studentët e universitetit ku studjoj (si Erasmus.....)	1	2	3	4	5

SESIONI III

Procesi i transparencës në kurrikulën universitare

Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

Ju lutem, vlerësoni nga 1 deri në 3, ku (1) është ”Aspak dakord ” ; (2) “Disi dakord”; (3)” **Shumë dakord**”.

Shpjegim:

Kurrikul universitare: [1] është përkufizuar gjerësisht si tërësia e përvojave të studentëve që realizojnë gjatë procesit të cikleve të ndryshme gjatë studimeve akademike.

[2] Termi shpesh i referohet në mënyrë specifike një përmbajtje të planifikuar akademike(module, kurse disiplinash universitare-leksion dhe seminare, praktika mësimore) shtrirë këto në Bachelor dhe vitet përkatëse, Master dhe vitet përkatëse.

A. Unë kam fituar njohuri për kurrikulën e degës ku studjoj para aplikimit në universitet	1	2	3
B. Unë kam fituar njohuri për kurrikulën e degës ku studjoj gjatë regjistrimit në fakultetin ku jam.	1	2	3
C. Unë kam fituar njohuri për kurrikulën e degës ku studjoj gjatë studimeve të mia.	1	2	3

D. Unë kam fituar njohuri për programin e kurseve të vitit akademik sapo fillon viti akademik	1	2	3
E. Unë kam fituar njohuri për programin e kurseve të vitit akademik në proces e sipër	1	2	3
F. Unë nuk i njoh fare programet e kurseve gjatë një viti akademik	1	2	3
G. Unë përdor literaturë të hapur (është studenti që vendos mbi tekstin referues në literaturën e programuar) gjatë përgatitjes në kurse akademike	1	2	3
H. Unë përdor literaturë të detyruar nga pedagogu i lëndës në përgatitjet për kursin	1	2	3
I. Unë përdor tekste akademike me ISBN të deklaruar	1	2	3
J. Unë përdor tekste akademike me çmim të deklaruar	1	2	3
K. Unë përdor tekste akademike me çmime speciale për studentët	1	2	3
L. Unë vlerësoj se orari mësimor i deklaruar në fillim semestri për kurset e lëndëve respektohet nga çdo pedagog lënde	1	2	3
M. Unë njoh publikisht cilësinë e vlerësimit në seancat e seminareve ku jam aktiv	1	2	3
N. Unë njoh vlerësimin për seminare dhe detyra të ndërmjetme para çdo provimi për kursin e lëndës	1	2	3
O. Unë sekretohem në materialet e prodhuara në çdo provim vlerësimi përfundimtar për kursin e lëndës	1	2	3
P. Unë njoftohem për deklarimin e sasisë së pikëve të fituara në provimin e vlerësimit përfundimtar për kursin e lëndës	1	2	3
Q. Unë njoh notën e marrë përmes sistemit elektronik të fakultetit	1	2	3
R. Unë njoh notën e marrë përmes deklarimit publik të pedagogut	1	2	3
S. Unë njoh notën e marrë përmes punjësve të sekretarisë mësimore	1	2	3
T. Unë kam përfituar nga procesi i rishikimit të notës së vënë nga pedagogu i kursit	1	2	3
U. Unë marr vlerësimin që meritoj larg presioneve për favore seksuale	1	2	3
V. Unë zotëroj dokument të arritjeve akademike në fund të çdo viti akademik, nëse i kërkoj ato	1	2	3
W. Unë kam zotëruar, sapo kam mbaruar, dokumentet shoqëruese për arritjet akademike sapo kam mbyllur ciklin akademik	1	2	3
X. Unë zotëroj brenda afateve të deklaruar për përgatitje çdo dokument që i kërkoj fakultetit	1	2	3

Y. Unë shoqëroj me pagesën në bankë kërkesën time për çdo dokument që më duhet nga fakulteti	1	2	3
--	---	---	---

SEKSIONI IV

Zgjedhjet dhe funksionimi i Këshillave Studentore.

Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem, vlerësoni nga 1 deri në 3, ku (1) është "Aspak dakord" ; (2) "Disi dakord"; (3) "Shumë dakord".

A. Unë kam informacion cilët janë përfaqësuesit e Këshillit Studentor në Fakultetin tim.	1	2	3
B. Unë kam informacion cilët janë studentët senator në Senatin e Universitetit.	1	2	3
C. Unë kam informacion dhe dijeni sa herë zhvillohen zgjedhjet për këshillat studentorë.	1	2	3
D. Unë kam mundësi të kandidoj lirisht si përfaqësues i Këshillit studentor sa herë bëhen zgjedhje në Fakultet.	1	2	3
E. Unë kam mundësi të njoh platformën e çdo kandidati për Këshillin Studentor.	1	2	3
F. Partitë politike përfshihen dhe ndikojnë në zgjedhjet e Këshillave Studentorë.	1	2	3
G. Pedagogët e Fakultetit ndikojnë në zgjedhjet e Këshillave Studentorë.	1	2	3
H. Stafi Drejtues i Fakultetit ndikon në zgjedhjet e Këshillave Studentorë.	1	2	3
I. Unë jam e kenaqur me punën e Këshillave Studentorë.	1	2	3
J. Këshillat Studentorë zhvillojnë aktivitete në mbrojtje të interesave të studentëve.	1	2	3

SESIONI V

Studenti rezistent ndaj korrupsionit dhe besueshmëria në institucionalizmin universitar

Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

Ju lutem, vlerësoni nga 1 deri në 5, ku (1) është "Aspak dakord" ; (2) "Disi dakord; (3) "Dakord"; (4) "Shumë dakord"; dhe (5) "Plotësisht dakord".

K. E vlerësoj veten si student rezistent ndaj fenomeneve korruptive në fakultetin ku studjoj.	1	2	3	4	5
L. E vlerësoj veten si student rezistent ndaj fenomeneve korruptive në universitetin ku studjoj.	1	2	3	4	5
M. E vlerësoj veten si student rezistent ndaj fenomeneve korruptive në arsimin e lartë në vend.	1	2	3	4	5
N. I vlerësoj miqtë e mi si studentë rezistentë ndaj fenomeneve korruptive në fakultetin ku studjojmë.	1	2	3	4	5
O. I vlerësoj miqtë e mi si studentë rezistentë ndaj fenomeneve korruptive në universitetin ku studjojmë.	1	2	3	4	5

P. I vlerësoj miqtë e mi si studentë rezistentë ndaj fenomeneve korruptive në arsimin e lartë në vend	1	2	3	4	5
--	----------	----------	----------	----------	----------

SESIONI VI

Besimi tek integriteti i institucioneve.

Qarkoni deri në 3 institucione tek të cilat ju besoni se ju mbështesin në rrezistencën tuaj ndaj korrupsionit në arsimin e lartë (në krah të institucioneve të qarkuara shenoni me (1) – për institucionin që ka besimin më të lartë tuajin deri (3), vendi i tretë në besimin tuaj.

- A. Rektori i universitetit
- B. Dekani i fakultetit.....
- C. Rektorati i universitetit.....
- D. Dekanati i fakultetit.....
- E. Senati i universitetit.....
- F. Përfaqësuesit e studentëve pranë Senatit të Universitetit.....
- G. Përgjegjësi i departamentit.....
- H. Komisioni i Etikës.....
- I. Këshilli Studentor.....
- J. Ministria e Arsimit.....
- K. Media.....
- L. Organizatë Jofitimprurëse studentore (jip emërtimin).....
- M. Organizatë Jofitimprurëse antikorruption (jip emërtimin).....
- N. Tjetër....
 - Asnjë

JU FALEMINDERIT!